

SKEDË TEKNIKE

RÖFIX Shirit gome izolues

ngjitës izolues.



Fushat e përdorimit

Izolim nga shiu i fugave lidhëse (p.sh dritare, parvaze dritaresh, trarë druri etj). Per izolimin e puthitjeve te detajeve lidhes te dritareve ne trupin e konstruksionit qendror pa sherbim shtese, ne sistemet e lidhjes me izolim termik SLIT per ndertesa te reja dhe te vjetra. Tipi: 15/4(HA) = 3-7 mm. Me qendrueshmeri ndaj temperaturave 30 °C deri + 100 °C, afatshkurter + 130 °C. Kategoria e ndertimit B1 (DIN 4102). Sjellja rreth. 25 %. Përdorimi i shiritit izolues , lejohet vetëm për gjerësitë e dhëna të lidhjeve. Vetëm në këto dimensionë, ato i përmbushin kërkesat për qëndrueshmëri ndaj rezeve UV dhe izolimin ndaj shiut. Lëvizjet e pjesëve të ndërtimit dhe ndryshimet në gjatësi si pasoje e temperaturave duhet të llogariten paraprakisht.

Karakteristikat

- Izolim jetëgjatë dhe me qëndrueshmëri ngaj kushteve atmosferike i fugave
- I mbulueshëm me bojë
- Imprenjimi i mases
- Shumë i hapur ndaj difuzionit të avullit

Përpunimi



Të dhëna teknike

Numri i artikullit	21652
EAN	9003304216529
Paketimi	
Sasi për njësi	52,5 mli/Nj.
Njësi për paletë	7 Copë/Nj.
Ngjyra	gri
Gjatësia	7500 mm
Gjerësia	15 mm
Thellësia	15 mm
Gjerësia e nyjes	3-12 mm
Reaksioni ndaj zjarrit	B1 DIN 4102
Difuzioni i avullit të ujit	rreth. 10
Temperatura e nënshtresës	5 °C

ROFIX Shirit gome izolues

ngjitës izolues.

Kushtet e punimit

Gjatë fazës së tharjes dhe përpunimit, temperatura e ambientit dhe bazamentit nuk duhet të bjerë nën +5 °C.

Bazamenti

Bazamenti duhet të jetë i pastër, i qëndrueshëm, i thatë, me aftësi mbajtëse, i lirë nga pluhurat, shpërthimet, elementët ndarës, koret dhe papastërtitë e çdo lloji. Cepat e lidhjeve duhet të jenë të pastra, të plota dhe pa vajra, yndyrna apo mbetje të ndryshme. Mbasi të vendosni për gjerësinë e lidhjes, zgjidhni dimensionin e shiritit duke e pershtatur e duke pasur parasysh tolerancat.

Bazamenti-Trajtimi paraprak

Kryeni provën e ngjitjes nëse bazamenti është i përshtatshëm për ngjitje.

Këshilla për përpunimin

Shiriti izolues mund të zgjerohet pa problem në zonën elastike qendrore (edhe plotësisht) ky komprimohet dhe kthehet mbrapsht thuajse në trashësinë fillestare me vendosjen e pllakave të izolimit. Prerjet duhet të bashkohen me përafërsisht. Për këndet pritni shiritin dhe bashkoni fundet në kënd, pa e rrotulluar rreth këndit.

Përpunimi

Mbas heqjes së qeses mbrojtëse nga pjesa e vetëngjithshme, ngjitni shiritin izolues direkt nga ruloja në pllakat termo-izoluese, në mënyrë që shiriti të jetë në një nivel ose më saktë të jetë e futur 3 mm me brënda fugave të pllakave. Para përpunimit ruajeni produktin në një vend të freskët. Priteni në të dyja anët, në fillimit dhe fund. Prerja ndarëse: Suvaja e sipërme pritët deri në suvanë mbushëse para fortësimi të plotë. Fuga mbetet e dukshme. Fuga suvaje deri 2 mm quhen „prerje suedeze“

Këshilla në rast reziku

Përbërësit: pa përmbajtje plastike dhe Halogen (< 5 M%).

Magazinimi

Magazinojini në vende të freskëta, të mbrojtur nga ngrica dhe të mbyllura mirë. Magazinimi min. 24 muaj.

Udhëzime teknike dhe ligjore

Gjatë aplikimit të produkteve tona, respektoni të dhënat në skemat teknike, të cilat janë në përputhje me standardet e përgjithshme dhe specifike të vendit, si dhe të merren parasysh rekomandimet e shoqatës kombëtare të specialistëve.

Këshilla të përgjithshme

Kjo skedë teknike anullon dhe zëvendëson të gjitha versionet e mëparshme. Të dhënat e këtyre udhëzuesve teknike përkojnë me njohuritë dhe përvojën tonë praktike të deritanishme. Ky informacion dhe të dhënat janë përpiluar me kujdes dhe me ndërgjegje të plotë, por pa mbajtur përgjegjësi për vendime ose veprime plotësuese që mund të marrë vetë konsumatori. Të dhënat në vetevete nuk provojnë asnjë lidhje ligjore ose detyrime të tjera anësore, dhe normalisht nuk e ndalojnë konsumatorin të testojë produktin për ato qëllime për të cilat edhe është prodhuar. Produktet ROFIX si dhe të gjitha materialet përbërëse, i nënshtrohen një kontrolli të vazhdueshëm, me anë të të cilit garantohej një cilësi e pandryshueshme. Stafi ynë është i gatshëm tju japë cdo ndihmë teknike në lidhje me përdorimin, përpunimin si dhe mund të ofrojë edhe trajnime praktike në lidhje me përdorimin e produkteve tona. Skemat tona teknike më të reja, me të dhënat aktuale, mund ti gjeni edhe në faqen tonë të internetit (www.roefix.com), ose mund të kërkojnë edhe pranë filjaleve rajonale në vënd. Të gjitha të dhënat teknike të dhëna në këtë fletë produkti janë përcaktuar në kushte laboratorike.